



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

SHPALL

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Kryeredaktor për kanalet televizive në gjuhën shqipe (nr. 2571)

1 pozitë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikon, organizon, mbikëqyrë dhe në bashkëpunim me Drejtorin e RTK TV-së, koordinon procesin e punës në të gjithë sektorët programor (informativ, edukativ, arsimor-shkencor, argëtues, fëmijëve dhe programit satelitor) të RTK -së, në TV të kanaleve në gjuhën shqipe, në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin dhe Kodin etik të gazetarisë në RTK;
- Harton dhe zbaton planin vjetor programor të RTK TV për të gjitha kanalet në gjuhën shqipe;
- Përgatit raporte periodike dhe vjetore lidhur me përmbushjen e planit vjetor programor;
- Zbaton normativat dhe standardet programore;
- Është përgjegjës për përmbajtjen programore të RTK TV për të gjitha kanalet në gjuhën shqipe;
- Koordinon punën e redaktorëve përgjegjës, producentëve ekzekutivë dhe nëpërmjet tyre redaktorëve të programeve të RTK TV në kanalet në gjuhën shqipe;
- Në bashkëpunim me Drejtorin e RTK TV-së në kanalet në gjuhën shqipe propozon dhe zbaton konceptin dhe strategjinë zhvillimore për programet e RTK TV-së në kanalet në gjuhën shqipe;
- Mban përgjegjësinë editoriale të programit, sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Bashkëpunon për përgatitjen e planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit programor;
- Mban takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Përgatit kushtet organizative për aftësim të stafit programor;
- Përcjellë njohuritë profesionale te bashkëpunëtorët;
- Është bashkëpërgjegjës për zhvillim dhe avancim profesional për bashkëpunëtorët;
- Detyra tjera të përcaktuara nga eprori.

I përzgjedhuri, për punën e vet në cilësinë e Kryeredaktorit për kanalet televizive në gjuhën shqipe, i raporton dhe i përgjigjet Drejtorit të Televizionit.

Kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
- Të ofrojë dëshmi që në kohën e aplikimit, nuk janë duke u zhvilluar hetime penale ndaj tij;
- Të mos ketë qenë i zgjedhur apo i emëruar (funksionar publik) gjatë tri (3) viteve të fundit;
- Të mos ketë qenë deputet, ministër, zyrtar i lartë i pushtetit qendror e lokal apo anëtar i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;
- Të mos ketë angazhime biznesi ose çfarëdo lloj çështjeje, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi, i paraparë në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

- Të ketë integritet të lartë profesional dhe moral.

Përveç kushteve të përgjithshme të cekura më lart, kandidati duhet të plotësojë edhe këto kushte dhe kriteret të veçanta:

- Të ketë kualifikim universitar;
- Të ketë së paku **4 (katër) vjet** përvojë pune në menaxhim editorial në media;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë dhe më gjërë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aplikimi i një standardi të lartë të gjuhës shqipe;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Njohuri pune me kompjuter;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe me palët;
- Caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion;
- Përkushtim ndaj transmetuesit publik;

Për këtë vend të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar 3 (tri) vjeçare, me periudhë provuese prej 6 (gjashtë) muajve.

Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Formulari për aplikim** (*Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni në ueb-faqen e RTK-së në këtë vjegëz: <https://www.rtklive.com/sq/page.php?ID=19>*)
- Curriculum Vitae (CV)** (*Dokumenti në fjalë – CV, Biografi, Rezyme – duhet të jetë i aktualizuar dhe duhet të përmbajë informacion të detajuar rreth të dhënave personale, shkollimit/edukimit, trajnimeve, përvojës së punës, aftësive profesionale, aftësive të buta, ose çfarëdo informacioni tjetër që konsiderohet se e pasuron dosjen e aplikimit*).
- Dëshmitë e kualifikimit universitar** (*Diplomat e fituara brenda vendit duhet të jenë të noterizuara, kurse diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga organet kompetente të Republikës së Kosovës*).
- Një kopje të letërnjoftimit ose të pasaportës valide** (*Dokumenti i identifikimit duhet të jetë i lëshuar nga Republika e Kosovës, duke dëshmuar kështu shtetësinë e aplikuesit*).
- Dëshmia e përvojës së punës në menaxhim editorial në media 4-vjeçare** (*Dëshmimi i përvojës së punës në menaxhim editorial në media duhet të bëhet nëpërmjet kontratave të punës ose vërtetimeve të punës të lëshuara nga punëdhënësit mbi marrëdhënien e punës. Dokumentet e dorëzuara duhet të japin informacion eksplicit lidhur me menaxhimin editorial në media dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të asaj pozite. Duhet të ofrohen data të qartat nisjes dhe përfundimit të kontratave/ angazhimeve paraprake*).
- Dy letra referuese profesionale** (*Dy letrat referuese duhet të lëshohen nga*

punëdhënësit/mbikëqyrësit paraprakë dhe/ose aktualë)

- g. Certifikata që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime dhe certifikata që dëshmon se aplikuesi nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale sipas kriterëve të konkursit** *(Certifikatat që dëshmojnë se aplikuesi nuk është nën hetime dhe që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale apo nuk ka një të kaluar kriminale duhet të merren në Policinë e Kosovës dhe gjykatën kompetente. (Certifikatat duhet të jenë të lëshuara gjatë muajit të fundit para aplikimit).*

Mënyra e përzgjedhjes të kandidatit

Procedurat, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së Kryeredaktorit për kanalet televizive në gjuhën shqipe, janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ (MPMP) nr. 07/2017 Për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik.

Mënyra e aplikimit

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skanuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, prej 16.05.2023 deri më datë 30.05.2023 në orën 23:59.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.

Informacion shtesë:

RTK siguron që procedurat e përzgjedhjes janë të hapura, ofrojnë konkurrencë jodiskriminuese, objektive dhe transparente, si dhe i gjithë procesi i përzgjedhjes është transparent.

Procesi i rekrutimit mund të monitorohet nga OJQ-të.

Për informata të tjera, kontaktoni zyrën e Administratës të RTK-TV në numrin +383 (0) 38 230 102